

**Njoftim për përqendrim me të cilin ORVAS shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për tregti, Kroaci do të fitojë kontroll mbi KANARIJA d.o.o. për ofrim të shërbimeve të marinës, Kroaci
(Lënda nr. 08-76/2025)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 16.04.2025, te Komisioni për Mbrojtje të konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit nga ORVAS shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për tregti, me seli në rr. Shën Leopold Mandiq 10, Dugopole, Republika e Kroacisë, mbi KANARIJA d.o.o. për ofrim të shërbimeve të marinës, me seli në Put Vele Luke 10, Supetar (Qyteti i Supetarit), Republika e Kroacisë.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

ORVAS d.o.o. shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për tregti, ka si veprimtari kryesore – veprimtari të agjencive të udhëtimit dhe operatorëve turistikë. ORVAS shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për tregti është shoqëri që në veçanti merret me veprimtari të agjencive të udhëtimit dhe operatorëve turistikë (të specializuar për shërbime të dhënies me qira të jahtesh me vela, anije motorike, katamarane, si dhe dhënie me qira të vilave turistike dhe akomodim hotelier në ishujt Hvar dhe Braç në Republikën e Kroacisë), dhe në masë më të vogël, si veprimtari dytësore, me aktivitete bujqësore (plantacione të veta të hardhisë dhe ullinjve) për prodhim të sasisë së vogël të verës dhe vajit të ullirit të destinuar për shitje brenda Grupit ORBICO.

ORVAS shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për tregti është pjesë e Grupit ORBICO dhe është 100% në pronësi të ORBICO SHPK. për tregti Zagreb. ORBICO SHPK për tregti Zagreb, me seli në rr. Koturashka Cesta 69, Zagreb, Republika e Kroacisë, është shoqëri që veçanërisht merret me tregti me shumicë dhe njëkohësisht është përfaqësues dhe distributor në territorin e Republikës së Kroacisë për një numër të madh të markave që variojnë nga produkte për kujdes dhe bukuri, produkte ushqimore dhe jo ushqimore, pajisje teknike dhe elektrike, barna, lodra, tekstile, cigare, vajra motorikë dhe shumë produkte të tjera.

Grupi ORBICO është i pranishëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes:

Shoqërisë për tregti dhe shërbime ORBICO SHPK Shkup, me seli në rr. Boris Trajkovski nr. 286, Komuna e Kisella Vodës, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut me veprimtari kryesore – tregti e pa specializuar me shumicë. Shoqëria është përfaqësues dhe distributor në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për një numër të madh markash të produkteve ushqimore, vajra motorikë, bateri, parfume, ujëra tualeti dhe deodorantë, kozmetikë dekorative, produkte për higjienë personale, produkte për kujdes, produkte për mirëmbajtje të higjienës në amvisëri.

KANARIJA d.o.o. për ofrim të shërbimeve të marinës, ka si veprimtari – veprimtari të marinave. KANARIJA d.o.o. për ofrim të shërbimeve të marinës është shoqëri që në veçanti merret me veprimtari të marinave (shërbime nautike që përfshijnë transport detar dhe bregdetar, dhënie me qira të mjeteve lundruese, transport për nevoja vetjake, shërbime të menaxhimit dhe lidhje/çlidhje të mjeteve lundruese të turistëve, mirëmbajtje dhe riparim të anijeve dhe mjeteve të tjera lundruese) në territorin e Republikës së Kroacisë, dhe në masë më të vogël me shërbime të dhënies me qira të hapësirave afariste. KANARIJA d.o.o. për ofrim të shërbimeve të marinës

nuk ka shoqëri të varura apo të lidhura dhe tërë veprimtarinë afariste e realizon ekskluzivisht në territorin e Republikës së Kroacisë.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar lidhur me këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni i fton palët e treta të interesuara që të dorëzojnë vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim në Komision. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, Shkup ose në e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda afatit prej 10 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

17.04.2025

Shkup